

ANDUEL TAHIRAJ

Drejtore i Administratës së Zonave të Mbrojtura Vlorë (ADZM Vlorë).

Z. Anduel Tahiraj ushtron detyrën e Drejtorit të Administratës Rajonale të Zonave të Mbrojtura Vlorë.

Me formim në fushën e inxhinierisë elektrike, z. Tahiraj është diplomuar në vitin 2011 pranë Fakultetit të Inxhinierisë të Universitetit Politeknik të Tiranës. Ka ndjekur gjithashtu studime të avancuara në fushën e inxhinierisë pranë Northcentral University dhe është pajisur me licenca profesionale në projektim nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë.

Gjatë karrierës së tij profesionale ka mbajtur disa pozicione teknike dhe drejtuese, ndër të cilat Kryeinxhinier, Shef i Njesisë së Tensionit të Lartë në Vlorë dhe Drejtues i OSHEE, Dega Vlorë. Në periudhën 2021–2025 ka ushtruar mandatin e Deputetit të Kuvendit të Shqipërisë, duke qenë i angazhuar në procesin legjislativ dhe hartimin e politikave publike.

Z. Tahiraj sjell një eksperiencë të gjerë në drejtim, administrim dhe menaxhim institucional, të cilën e vë në funksion të administrimit dhe menaxhimit të zonave të mbrojtura në qarkun Vlorë.